

NJOFTIM PËR PUBLIKUN

Prishtinë
5 mars 2019

Përmes këtij njoftimi Lotaria e Kosovës dëshiron të njoftoj publikun dhe pjesmarrësit në lojërat e fatit se në lojën Joker, xhiro 102 e luajtuar më 22 dhjetor 2018, ka pasur një fitues me Joker 6 në shumë prej 72,803.42 Euro.

Siq parashihet me Ligjin për lojërat e fatit, neni 17 paragrafi 1¹; tërheqja e fitimeve duhet të bëhet në afat kohor prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e shpalljes së fituesit. Në rastin e lartpërmendur, fituesi nuk është paraqitur që të bëjë tërheqjen e shumës së fituar dhe afati kohor prej gjashtëdhjetë (60) ditësh ka kaluar.

Lotaria e Kosovës ka vepruar në bazë të Ligjit për lojërat e fatit, bazuar në nenin 17, paragrafi 2² dhe 3³ dhe Komisioni i caktuar për këtë rast ka marrë vendim që shuma e lartëcekur të ju kthehet pjesëmarrësve të Lotarisë së Kosovës duke u bartur në fondin e fitimit për lojërat Loto dhe Joker.

¹ *Pagesa e fitimit monetar, tërheqja e fitimeve të llojeve të tjera të lojërave, ushtrohet në afatin e përcaktuar me rregullat e lojës, dhe nuk mund të jetë më i gjatë se gjashtëdhjetë (60) ditë nga dita e shpalljes së raportit për rezultatin e lojërave të lotarisë.*

² *Organi kompetent i Lotarisë së Kosovës dhe Komisioni të cilin e përcakton Bordi Menaxhues, e bënë evidencimin e numrit të saktë dhe të shumës së përgjithshme të fitimeve të papaguara për secilën lojë.*

³ *Mjetet nga paragrafi 2. i këtij neni, duhet t'u kthehen pjesëmarrësve nëpërmjet rritjes së fondit për fitime nga loja konkrete apo lojërat e tjera.*